

FAKULTETI I ARKITEKTURËS, DIZAJNIT DHE TEKNOLOGJISË SË DRURIT

Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit ofron program të studimeve në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn të Mobilieve, në ciklin e parë, pra në bachelor, program në Dizajn dhe Konstruksion të Produkteve nga Druri, poashtu në ciklin e parë, pra në bachelor, si dhe program në Arkitekturë dhe Dizajn të Interierit me Prodhime nga Druri, në ciklin e dytë, pra në Master. Programet janë të organizuara në module dhe të vlerësuara me kredi (ECTS), të cilat janë në përputhje me sistemin evropian të kredive.

Fakulteti ka një staf të kualifikuar, ka ambiente moderne të punës, si dhe laboratore e pajisje moderne, të cilat u mundësojnë studentëve të zotërojnë shkathhtësitë e duhura për profesionin, të cilin do ta ushtrojnë në të ardhmen.

Mendime të studentëve rreth përzgjedhjes së programit të studimeve në UShAF

Resul Qorrolli, student në vitin e tretë në programin e studimeve Arkitekturë e Interierit dhe Dizajn i Mobilieve:



“Organizimi i panairove dhe ekspozitave me kompanitë private, në kuadër të Universitetit, më kanë dhënë mundësi të mira punësimi qysh në fillim të studimeve. Puna praktike e realizuar në semestrin e tretë të studimeve, në një studio projektuese, më mundësoi që nga semestri i katërt të filloj me punë të rregullt në po të njëjtën kompani. Prandaj mund të them se jam i lumtur që përzgjodha Fakultetin e Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit, në UShAF dhe bëra zgjedhjen e duhur për të ardhmen time.”

Lorita Rama, Studente në vitin e tretë në programin e studimeve Arkitekturë e Interierit dhe Dizajn i Mobilieve:

“Falë angazhimit të menaxhmentit, stafit akademik dhe administrativ të UShAF, unë po ndjek studimet në Universitetin e Ekologjisë dhe Menaxhmentit në Varshavë, përkatësisht në profilin Arkitekturë e Interierit, mundësi kjo që mu dha në kuadër të programeve të mobilitetit.”



Skeno QR CODE
për të parë video materiale



BAÇELOR

Ky program është i fokusuar në zhvillimin e shkencës së drurit, përmes përdorimit të teknologjisë dhe aplikimit të praktikave më moderne, të cilat zbatohen në ditët e sotme, jo vetëm në Kosovë, po në mbarë botën. Shkathësitë që studentët do t'i zotërojnë janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

- të aplikojnë njohuritë e tyre teorike dhe praktike në hartimin e një punimi/ projekti kërkimor.

MUNDËSI PUNËSIMI NË TË ARDHMEN

Pas përfundimit të studimeve, i diplomuari do të mund të punonte në:

- dizajnimin e produkteve nga druri,
- dizajnimin e interierit,
- mësimdhënie në institucione fillore dhe të mesme teknike,
- studio projektuese,
- procesin edukativo-arsimor,
- ndërmarrje prodhuese të mobileve dhe interierit, ose
- biznese dhe kompani të menaxhimit të produkteve.

QËLLIMI

Me ndërlidhjen e mësimit teorik e praktik, me angazhimin në laboratore si dhe me realizimin e projekteve të ndryshme, programi ka për qëllim t'u ndihmojë studentëve të zotërojnë shkathësitë adekuate, të cilat i përgatitin ata jo vetëm për tregun kombëtar, po edhe për atë ndërkombëtar.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Që studentët të kenë sukses në të ardhmen, në një mjedis konkurrues dhe që ndryshon vazhdimisht, Universiteti u ofron mësim teorik dhe praktik, i cili u ndihmon:

- të zhvillojnë konceptet themelore në dizajn dhe arkitekturë të interierit, si dhe të inxhinierisë së prodhimit;
- të njohin matetialet nga druri dhe teknologjitë e përpunimit të tyre;
- të zhvillojnë dhe dizajnojnë produkte të përshtatshme për treg (përfshi hulumtimin e tregut, planifikimin, dizajnimin, kalkulimin etj); dhe

Viti I

Semestri I			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Bazat e Arkitekturës së Interierit	5
2	O	Vizatimi i Lirë	5
3	O	Matematikë dhe Statistikë	6
4	O	Informatikë e Aplikuar	5
5	O	Historia dhe Stilet në Arkitekturën e Interierit	4
6	O	Vizatim Teknik & Gjeometri Deskriptive	5

Semestri II			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Materialet në Interier	6
2	O	Shkathësi Akademike	6
3	O	Antropometria dhe Ergonomia	6
4	O	CAD I	6
5	O	Gjuhë Angleze I	3
6	O	Gjuhë Gjermane I	3

Viti II

Semestri III			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Teknikat e Punës në Interier	5
2	O	Ekonomi dhe Ndërmarrësi	4
3	O	CAD II	6
4	O	Teknologjitë e Prodhimit të Mobileve	5
5	O	Konstruksionet e Interierit dhe Mobileve	4
6	O	Gjuhë Angleze II	3
7	O	Gjuhë Gjermane II	3

Semestri IV			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Projektimi Arkitektonik	5
2	O	Dizajni i Produktit	4
3	O	Gjuhë Angleze III	6
4	O	Gjuhë Gjermane III	5
5	O	CAD III	4
6	O	Digjitalizimi i prodhimit	3
7	O	Planifikimi i Hapësirës dhe Kriteret Teknike në Interier	3

Viti III

Semestri V			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Marketingu dhe Teknikat e shitjes	4
2	O	Kontrulli i Cilësisë	4
3	O	Studio Dizajn	5
4	O	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	4
5	O	Mobiliet e Buta	4
6	O	Ngjitja dhe Përpunimi Sipërfaqësor i Drurit	5
7	O	Përgatitje Teknike e Prodhimit	4

Semestri VI			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Praktikë	4
2	O	Mirëmbajtja dhe Restaurimi i Interierit	5
3	O	Menaxhimi i Projekteve	4
4	O	Ekologjia dhe Shkenca e Ambientit	4
5	O	Kalkulimi i kostos dhe Vendosja e Çmimit	4
6	O	Dizajni i Hapësirave Komerciale	4
7	O	Ngjyrat, Ndriçimi dhe Akustika në Interier	5

O - Lëndët Obligative, Z - Lëndët Zgjedhore, ECTS - (European Credit Transfer System) | (Sistemi Evropian i Transferimit të Kredisë)

BAÇELOR

Programi Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve nga Druri u ofron studentëve standardet më të larta ndërkombëtare të edukimit në këtë fushë. Përmbajtja dhe strukturimi i këtij programi vjen si rezultat i kërkesave të shtuara të subjekteve, të cilat merren me veprimtarinë e mobilieve dhe me dizajnin e hapësirave të brendshme. Programi ofron lëndë me përmbajtje bashkëkohore dhe fleksibile, të cilat në vazhdimësi përcjellin kërkesat e industrisë vendore dhe ndërkombëtare, duke krijuar kështu kuadro profesionale që do të ndihmojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.

meve dhe të vendimmarrjes, në raste të dizajnit dhe zgjidhjeve konstruktive të produktit që do të prodhohet;

- të praktikojnë aftësi efektive të komunikimit me punëtorë të ndërmarrjes; dhe
- të dijnë të llogarisin çmimin e produktit të prodhuar dhe të dijnë të menaxhojnë prodhimin e produkteve.

MUNDËSI PUNËSIMI NË TË ARDHMEN

Pas përfundimit të studimeve, i diplomuari do të mund të punonte në:

- dizajnimin e hapësirave të brendshme,
- dizajnimin e hapësirave të interierit në objekte banimi kolektive dhe ato individuale,
- studio projektuese,
- procesin edukativo-arsimor,
- ndërmarrje prodhuese të mobilieve dhe interierit,
- ndërmarrje ku përdoren software aplikativ për interier, ose
- biznese dhe kompani të menaxhimit të produkteve.

QËLLIMI

Programi, me mundësitë që ofron në realizimin e objektivave, ka për qëllim të përgatisë studentë, të cilët në mënyrë profesionale do të ekzekutojnë aktivitete të ndryshme në ndërmarrjet prodhuese, kryesisht në ato ndërmarrje të cilat merren me prodhimin e interierit të brendshëm, me fokus në mobilie dhe ndërmarrje të tjera të cilat merren edhe me konstruksione nga druri.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Që studentët në të ardhmen të kenë sukses në një mjedis konkurrues dhe që ndryshon vazhdimisht, Universiteti u ofron mësim teorik dhe praktik, i cili u ndihmon:

- të dijnë të bëjnë skicimin e produktit;
- të demonstrojnë aftësitë e të menduarit kritik në zgjidhjen e problemeve komplekse të dizajnit dhe konstruksioneve të produktit që do të prodhohet;
- të implementojnë aftësitë teknike, të cilat duhet të ndërmerren për prodhimin e produktit;
- të aplikojnë proceset e zgjidhjes së proble-

Viti I

Semestri I			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Matematikë e Aplikuar	6
2	O	Vizatim Teknik dhe Gjeometri Deskriptive	6
3	O	Shkathësi Informatike	5
4	O	Druri dhe Nënproduktet e tij	5
5	O	Ekonomi dhe Ndërmarrësi	4
6	O	Historia e Dizajnit dhe Mobilieve	4

Semestri II			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Përpunimi Primar i Drurit	6
2	O	Materialet në Interier dhe Eksterier	6
3	O	Aplikimi i CAD në projektimin e mobilieve I	6
4	O	Shkathësi Akademike dhe Komunikimi	6
5	O	Gjuhë Angleze I	3
6	O	Gjuhë Gjermane I	3

Viti II

Semestri III			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Antropometria dhe Ergonomia	5
2	O	Konstruksione Druri I	5
3	O	Dizajni i Interierit I	5
4	O	Bazat e Mekanikës	5
5	O	Ngjitja e Drurit	4
6	O	Gjuhë Angleze II	3
7	O	Gjuhë Gjermane II	3

Semestri IV			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Konstruksione Druri II	5
2	O	Teknologjitë e Prodhimit të Mobilieve	5
3	O	Tharja dhe Mbrojtja e Drurit	5
4	O	Aplikimi i CAD në Projektimin e Mobilieve II	5
5	O	Mbrojtja dhe Siguria në Punë	4
6	O	Gjuhë Angleze III	3
7	O	Gjuhë Gjermane III	3

Viti III

Semestri V			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Makinat CNC	4
2	O	Kontrolli i Cilësisë së Produkteve nga Druri	4
3	O	Ekologjia dhe Shkenca e Ambientit	4
4	O	Dizajni i Interierit II	4
5	O	Teknikat e Punës në Interier	5
6	O	Dizajni i Eksterierit	5
7	O	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	4

Semestri VI			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Përpunimi Sipërfaqësor i Drurit	6
2	O	Menaxhimi i Projekteve	5
3	O	Praktikë	6
4	O	Mobiliet e Buta	4
5	O	Mirëmbajtja dhe Restaurimi i Produkteve nga Druri	5
6	O	Menaxhimi dhe Llogaritja e Kostos	4

MASTER

Programi Arkitekturë dhe Dizajn i Interierit me Prodhime nga Druri, në nivelin master, u hartua bazuar në kërkesat e tregut të punës si dhe përmes një bashkëpunimi të ngushtë me komunitetin e biznesit. Prandaj, mund të themi se programi përmbush mangësi të shumta të tregut të punës në Kosovë, duke kualifikuar studentë me njohuri dhe shkathtësi adekuate, të cilat do të mund t'i aplikojnë në të ardhmen.

QËLLIMI

Programi Arkitekturë dhe Dizajn i Interierit me Prodhime nga Druri ka për qëllim të zhvillojë kuadro të profesionalizuara në fushën e arkitekturës dhe dizajnit të interierit, me fokus në zhvillimin e dizajnit dhe prodhimin e produkteve nga druri duke përdorur teknologji dhe aplikacione moderne, të cilat zbatohen sot në vend dhe më gjerë, dhe që u përshtaten kërkesave të tregut të punës.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Që në të ardhmen studentët të kenë sukses në një mjedis konkurrues dhe që ndryshon vazhdimisht, Universiteti u ofron mësim teorik dhe praktik, i cili u ndihmon:

- të kategorizojnë dimensionet antropometrike (trupore) dhe të përshtasin dimensionet e produkteve sipas këtyre kërkesave;
- të dizajnojnë hapësira të interierit (komerciale dhe jokomerciale);
- të dizajnojnë produkte të interierit (moblie, veshje muresh etj);
- të vendosin kritere për konstruktimin e produkteve;
- të aplikojnë dhe justifikojnë ngjyrat dhe ndriçimet në interier;
- të shfrytëzojnë programe moderne kompjuterike (CAD, 3DMAX, ArchiCAD, Fusion, Rhino, Alphacam Creo etj) për dizajnimin dhe analizimin/ simulimin e funksionimit të produktit të dizajnuar;
- të planifikojnë, iniciojnë dhe ekzekutojnë pro-

- jekte të ndryshme inxhinierike;
- të menaxhojnë produkte dhe grupe (familje) të produkteve, që nga ideja, dizajni e deri te zhvillimi i tij gjatë gjithë ciklit të tij jetësor;
- të punojnë në mënyrë individuale dhe grupore në problemet teorike dhe praktike (duke gjetur dhe aplikuar metodat adekuate të hulumtimit shkencor);
- të kuptojnë kompleksitetin e procesit të operacioneve të prodhimit dhe ndikimin e tij në dizajnin e mobilieve, dhe anasjelltas;
- të analizojnë mbrojtjen e ambientit dhe përdorimin e materialeve mike të ambientit;
- të menaxhojnë brendingun dhe dizajnin strategjik; dhe
- të menaxhojnë produktet.

MUNDËSI PUNËSIMI NË TË ARDHMEN

Pas përfundimit të studimeve, i diplomuari do të mund të punonte në:

- dizajnimin e produkteve për konsum masiv ose për klient individual,
- dizajnimin e hapësirave të interierit, në objekte banimi kolektive dhe ato individuale,
- studio projektuese,
- procesin edukativo-arsimor,
- ndërmarrje prodhuese të mobilieve dhe interierit,
- ndërmarrje ku përdoren software aplikativ për interier, ose
- në biznese dhe kompani të menaxhimit të produkteve.

Viti I			
Semestri I			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Metodat Kërkimore	6
2	O	Ndërmarrja, Marka e Produkteve dhe Mallrave	6
3	O	Projektimi i Interierit nga Materialet Drusore	6
4	O	Ergonomia dhe Dizajni i Mobilieve	6
5	O	Ligjet në Dizajnin e Interierit	6
Semestri II			
1	O	Ndriçimi Ngjyrat dhe Akustika në Interier	5
2	O	Parimet dhe Zbatimi i Menaxhimit të Produkteve	5
3	O	Modelimi me Teknologjitë 3D	5
4	O	Konstruksionet e Mobilieve	5
5	Z	Menaxhimi i Projekteve	5
6	Z	Arti Dekorativ në Interier	5
7	Z	Inovacionet në Dizajnin e Mobilieve	5
8	Z	CAD Specializim	5
9	Z	Gjuhë Angleze	5
Viti II			
Semestri III			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Vizualizimi	5
2	O	Dizajni Strategjik dhe Universal	5
3	O	Përgatitja, Përcjellja dhe Kontrolli i Produktit	5
4	O	Intership në Arkitekturë dhe Dizajn të Interierit	5
5	Z	Aplikimi i Dizajnit me Teknologjitë CNC	5
6	Z	Menaxhimi i Zinxhirit Furnizues	5
7	Z	Komunikimi Grafik	5
8	Z	Gjuhë Gjermane	5
Semestri IV			
1	O	Tema e masterit	30

O - Lëndët Obligative

Z - Lëndët Zgjedhore

ECTS - (European Credit Transfer System) | (Sistemi Evropian i Transferimit të Kredisë)

Për tu informuar rreth mundësive për të studiuar në UShAF, bëhuni pjesë e aktivitetit “Open Doors” me datën 17, 18, 19 Maj dhe shihni mundësitë që ofron Universiteti ynë.

Me ne, jeni më afër tregut të punës!

Ofrojmë siguri në ecjen tuaj përkrah studentëve të vendeve të zhvilluara!

Bashkë mund ta zhvillojmë Kosovën!



FACEBOOK.COM/USHAF.NET



INSTAGRAM.COM/USHAFERIZAJ



UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ

**Rr. Universiteti, p.n. 7000 Ferizaj, Kosovë
Tel.+381 290 310 010 | www.ushaf.net**